


Zgjedhjet Parlamentare 2025: Më 11 maj votohet për deputetët e Kuvendit

VOTIM DHE NUMËRIM ELEKTRONIK NË QARKUN TIRANË

BASHKIA VORË
NJ. ADMINISTRATIVE NR. 10 TIRANË


SI TË VOTOSH ME PAJISJEN ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT

1




Në ekran shfaqet **lista e partive dhe koalicioneve** si dhe opsioni **"Nuk zgjedh Subjekt"**.

2



Vendos gishtin mbi emrin e partisë ose koalicionit që do të zgjedhësh, ose vendos gishtin mbi **"NUK ZGJEDH SUBJEKT"** kur nuk dëshiron të zgjedhësh asnjë parti ose koalicion.

3




Shenja **X** shfaqet në kutinë për bri zgjedhjes suaj.
Vendos gishtin mbi butonin **"Konfirmo votën"** në fund të ekranit për të vazhduar.
Në rast se ke zgjedhur opsionin **"Nuk zgjedh subjekt"** kalo në hapin 7.

4




Në ekran shfaqen **emrat e kandidatëve** nga lista e hapur e partisë/koalicionit që keni zgjedhur, si dhe opsioni **"Nuk zgjedh kandidat"**.

5



Vendos gishtin mbi emrin e kandidatit që do të zgjedhësh, ose vendos gishtin mbi **"NUK ZGJEDH KANDIDAT"** kur nuk dëshiron të zgjedhësh asnjërin nga kandidatët.

6




Shenja **X** shfaqet në kutinë për bri zgjedhjes suaj.
Vendos gishtin mbi butonin **"Printo votën"** në fund të ekranit për të vazhduar, ose mbi butonin **"Kthehu mbrapa"** për tu kthyer tek lista e partive/koalicioneve.

7



Në kutinë e votimit në krahun tuaj do të **printohet vota** me zgjedhjen tuaj. Gjithashtu në ekran do të shfaqet e njëjta pamje me zgjedhjen tuaj.

8



Ti ke një mundësi të fundit për të ndryshuar zgjedhjen duke vendosur gishtin mbi butonin **"Nrysho zgjedhjen nëse dëshiron"** dhe të përsërisësh hapat e mëparshëm.
Nëse je dakord me rezultatin, vendos gishtin mbi butonin **"Përfundo votimin"**.

JE VOTUES PËR
HERË TË PARË?
TANI ËSHTË
MOMENTI YT PËR TË
NDIKUAR

KY ËSHTË NJË
PROCES I SIGURT,
I LEHTË DHE I
SHPEJTË. NDIQ
HAPAT DHE VOTO I
QETË

Zgjidh me mendje, jo me zakon – krahaso ofertat politike!
Zgjedhjet janë më 11 maj – Voto me dije, jo me dyshim!